



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
KËSHILLI KOMBËTAR



Tiranë, më 13/06/2025

VENDIM Nr.22

Nr.22, datë 13.06.2025

Në mbështetje të ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenin 15, pika 3, gërma a) të këtij ligji, dhe Vendimin nr 6 të datës 03.04.2025, pika 10 të Këshillit Kombëtar, në prezencë të anëtarëve; Znj.Valbona Treska, Znj.Valbona Habili, Znj.Rezarta Basha, Znj.Elona Mustafaraj, Znj. Manolita Hida, Znj.Elisabeta Koza, Znj.Irena Binjaku, Znj.Markeljana Pina, Z.Edvin Lame (online), (prezent edhe Z.Bledar Zeneli, që deklaroi se nuk dëshiron të jetë pjesë e votimit dhe nuk dëshiron të llogaritet në kuorum), pasi mori në shqyrtim dokumentacionin zgjedhor të përcjellë nga Komisioni Zgjedhor datë 06.06.2025, i thirrur me rend dite:

- *Shqyrtimi i rregullsisë së procesit, arritjes së korumit sipas Ligjit 40/2016 “ Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë” neni 15, pika 3, gërma a) vlefshmërisë së procesit, garancisë së standardeve të votimit, respektimin e të drejtës së votimit dhe garantimin e shprehjes së vullnetit nëpërmjet votës, për të shpallur rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, në bazë të Vendimit Nr.6, datë 03. 04. 2025 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut.*

Me 8 (tetë) vota pro, asnjë kundër, (Z.Bledar Zeneli deklaroi se nuk merr pjesë në votim, Znj.Elona Mustafaraj nuk merr pjesë në votim)

VENDOSI:

1. Të konstatojë se:

- sipas Regjistrimit të anëtarëve aktivë me të drejtë vote të Urdhrit të Psikologut në datën 05.06.2025 rezulton se në momentin e votimit Asambleja Kombëtare përbëhet nga 1480 anëtarë.



- bazuar në procesverbalin e Komisionit Zgjedhor të datës 05.06.2025 rezulton se kanë marrë pjesë në votim 451 anëtarë.

Në këto kushte, bazuar në Ligjin 40/2016, neni 15, pika 3, gërma a), **konstaton se nuk është arritur shumica e thjeshtë e të gjithë anëtarëve për të zgjedhur Presidentin dhe Këshillin Kombatër.**

2. T'i dërgohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rikujtesë për përshpejtimin e ndryshimeve ligjore të dërgura me shkresën nr.129 prot. datë 24.02.2025.

PRESIDENTE E URDHRI
Dr.Valbona TRESKA

SEKRETARE
Arlinda KËRÇI

